**Data 16.06.2023.**

**.**

**<u>PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË</u>**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT**: **"Ndertim i shkolles se Mesme Polis +Palester ,Nj.Adm.Polis Bashkia Librazhd.**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV : Punime ndertimi - 45000000-7**

**Fondi limit**: **93 146 734 (nentedhjete e tre milion e njeqind e dyzet e gjashte mije e shtateqind e tridhjete e kater ) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*c. Formularin e ofertes + preventivin.*

**Argumentimi**: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

Sipas kritereve te pergjithshme per kualifikim.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paraprafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

**2.2.2** Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të

deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike",etj.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar per vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Shënim : Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.**
**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar.

**3.Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

**a)** dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e fondit limit të lotit për të cilin konkuron dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

**b)** dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i fondit limit të lotit për të cilin konkuron.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.

**Shënim :** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

<u>Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.1, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatoren e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.</u>

***Argumentimi**:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 42, , në rastin e procedurave të hapura, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme ne nje objekt te vetem të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose per punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur ne rendesine e objektit te prokurimit, vleren e fondit limit te vene ne dispozion , tipologjine e punimeve te ndertimit si edhe mbeshtetur ne LPP dhe ne RRPP.

**<u>Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:</u>**

**<u>2.3.2</u>** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë::

-
- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**
-
- N.P – 1 B (Punime gërmimi në tokë).
- N.P - 2 C (Ndertime civile dhe industriale
- N.P – 3 C (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada).
- N.P – 12 B (Punime të inxhinierisë së mjedisit).

- **Për punimet speciale të ndërtimit:**
-
- N.S – 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve).
- N.S- 2 A (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre).
- N S 3- A Impiante gritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues )
- N.S.- 4 C (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).
- N.S – 8 A (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri).
- N.S - 12 B (Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit).
- N.S – 14 B (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj).
- N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).
- N.S – 19 A ( Sisteme kundra zhurmes per infrastructure ).
- NS - 20 A **(** Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

***Argumentimi****:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbeshtetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|---|---|---|---|---|
| N.P – 1 B | (Ndertime civile dhe industriale | Percaktimet ne preventiv | B | E kalon vleren 20 milion leke. |
| N.P - 2 C | (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada). | Percaktimet ne preventiv | C | E kalon vleren 50 milion leke. |
| N.P – 3 C | Punime të inxhinierisë së mjedisit). | Percaktimet ne preventiv | C | Nuk e kalon vleren 50 milion leke. |
| N.P – 12 B | (Punime të inxhinierisë së mjedisit). | Percaktimet ne preventiv | B | Nuk e kalon vleren 20 milion leke. |
| N.P – 12 B | (Punime të inxhinierisë së mjedisit) | Percaktimet ne preventive | B | E kalon vleren 20 milion leke |
| N.S – 1 A | (Punime për prishjen e ndërtimeve). | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke. |
| N.S- 2 A | (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke. |
| N S 3- A | Impiante gritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke. |
| N.S.- 4 C | (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik | Percaktimet ne preventive | C | E kalon vleren 50 milion leke |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese | | | |
| N.S – 8 A | Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke. |
| N.S - 12 B | (Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit | Percaktimet ne preventive | B | E kalon vleren 20 milion leke |
| N.S – 14 B | - (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj). | Percaktimet ne preventive | B | E kalon vleren 20 milion leke |
| N.S – 18 A | - (Punime topogjeodezike).<br>- | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke |
| N.S – 19 A | - ( Sisteme kundra zhurmes per infrastructure ). | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke |
| NS - 20 A | - ( Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime | Percaktimet ne preventive | A | Nuk e kalon vleren 20 milion leke |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | për ujë. | | | |

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Librezë pune;
b) Kontratë pune e vlefshme;
c) Diplomë.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

d) Librezë pune;
e) Kontratë pune e vlefshme;
f) Diplomë.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik te perfshire në liçencën e shoqerise me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt te vertetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa per 3 (tre) muajt e fundit si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhiniere Ndertimi
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi ( profile strukturist)
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhiner Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve dhe kontrata pune.*
*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

***Argumentimi**:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" bazuar ne perllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*", pika 2 ku përcaktohet se: "*Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit*" dhe pika 2: "elementët e licensës" gërma "c" ku citohet se: "*Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. <u>Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë.</u> Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë*".
Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitave ligjore në fuqi.

**2.3.5**Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik mbeshtetes për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire në liçencën e shoqerise me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt te vertetuar me,

diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

1 (një) Arkitekt

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (nje) Inxhinier Ndertimi /strukturist

1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (*Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").*

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe perpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzektuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.
Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.5, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në "Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike" ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmive të kualifikimit të sigurimit teknik.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore,

dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë

- Punonjës teknik ndërtimi 1 (një)
- Punonjes teknik mekanik 2 (dy)
- Punonjes teknik topograf 1( nje)
- Hidraulik 2 (dy)
- Elektriçist 3 (tre)
- Betonues 3(tre)
- Murator 3 (tre)
- Bojaxhi 5(pese)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Hidroizolues 2 (dy)
- Karpertier 2 (dy)
- Suvatues 4 (kater)
- Pllakashtrues 3 (tre)
- Specialist per sistemet e kondicionimit 3 (tre)
- Specialist per punime gipsi 2 (dy)
- Specialist per punimet ne lartesi 2 (dy)
- Punetore ndertimi 15 (pesembedhjete)

-Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektricist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatësë, si dhe institutcionin qe ka leshuar kete dokument.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **5 (pese)** punonjës manovratorë të mjeteve të rënda dhe **5 (pese**) punonjës shoferë kamionash. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, (bazuar ne legjislacionin ne fuqi) dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), si dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të. Të dhënat për punonjësit sa më sipër të paraqiten në formatin e deklaratës së kërkuar në pikën 2.3.6

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektricist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës

individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatësë, si dhe institutcionin qe ka leshuar kete dokument.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj.

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës, (bazuar ne legjislacionin perkates ne fuqi);
- Dëshmi kualifikimi te leshuara nga institucione arsimore shteterore apoprivate te miratuara nga institucionet perkatese si dhe certifikata të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent.
- Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf të paraqiten edhe diplomat e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse.

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm: Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës te vlefshme (bazuar ne legjislacionin perkates ne fuqi);;
- diplomë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuara nga /ish (IQT), e cila duhet te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme (bazuar ne legjislacionin perkates ne fuqi);
- leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*
- *Per punetoret e ndertimit operatori ekonomik duhet te paraqese kontrate pune te rregullt si dhe te figurojne punetoret ne listepagesat e shoqerise per tre muajit e fundit.*
- Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

| Nr | Emer Mbieme | Profesioni | Data e fillimit marredhenieve te pun | Nr.certifikates profesion | Institucioni/Subjekti certifikues |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |

***<u>Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.</u> <u>Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe perpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari  që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.</u>***

**Argumentimi**: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor  të nevojshme për  te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzektuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me  dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në "Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike" ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmive të kualifikimit të sigurimit teknik.

**2.3.15** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

| **Nr** | **Lloji i makinerive** | **Pronësia** | **Njësia** | **Sasia** |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Kamiona vetshkarkues , kapaciteti mbajtës mbi   15 ton | në pronësi ose me qera | cope | 3 |
| 3 | Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht deri ne 10 ton | në pronësi ose me qera | cope | 3 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht 3.5 – 5 ton | në pronësi ose me qera | cope | 1 |
| 6 | Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 ton | në pronësi ose me qera | cope | 2 |
| 7 | Autobetonierë | në pronësi ose me qera | copë | 3 |
| 8 | Autopompe betoni | në pronësi ose me qera | cope | 1 |
| 9 | Rimorkiator | Pronësi ose me qira ose kontrate furnizimi | copë | 1 |
| 10 | Fadrome | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 11 | Pompe suvatimi | në pronësi ose me qera | copë | 2 |
| 12 | Matrapik per thyerje betoni | në pronësi ose me qera | copë | 2 |
| 13 | Autobot uji | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 14 | Betoniere / vellimi 1 m3 | në pronësi ose me qera | copë | 2 |
| 15 | Autovinc | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 16 | Minieskavator | në pronësi ose me qera | copë | 2 |
| 17 | Minifadroma | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 18 | Krik ngrites | në pronësi ose me qera | copë | 3 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 19 | Kantier stacionar | në pronësi ose me qera | cope | 1 |
| 20 | Gjeneratore | në pronësi ose me qera | cope | 2 |
| 21 | Tranxhe hekuri | në pronësi ose me qera | cope | 1 |
| 22 | Skele suvatimi | në pronësi ose me qera | M2 | 3500 |
| 23 | Nivelues per shtresa betoni | në pronësi ose me qera | cope | 2 |
| 24 | Pirun ngrites | në pronësi ose me qera | Cope | 1 |
| 25 | Kompresor | në pronësi ose me qera | Cope | 2 |
| 26 | Vinxh Kulle 40m | në pronësi ose me qera | Cope | 1 |

Sqarim lidhur me kerkesen e mjeteve te mesiperme:

1) Kamiona vetshkarkues, kapaciteti mbajtës mbi 15 ton, eshte i nevojshem per transportimin e materiale te krijuara nga prishja, por jo vetem, te cilat cilat rezultojne me shume se 5000ton vetem per prishjen e nderteses.
2) Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht deri ne 10 ton , ky mjet vjen ne ndihme te kamionit me kap mbajtes mbi 15 ton ne menyre qe sheshi te aksesohet nga disa drejtime per te ruajtur, ndikimin ne mjedis nen normat e lejuara gjate punimeve te prishjes.
3) Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht 3.5 – 5 ton, ky mjet perdoret per materialet me pesha specifike me te vogel se materialet e prishjes (kryesisht betone strukturore, tulla etj), gjithshtu jane te domosdoshem per aksesin e tyre ne gjeresi te kufizuara ne sheshin e ndertimit
4) Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 ton, ky mjet eshte i domosdoshem per transportin e materialeve brenda dhe jashte kantierit te ndertimit duke rezultuar ne nje efikasitet ne kohe dhe cmim.
5) Autobetonierë, ky mjet eshte i nevojshem per punimet e betonit te armuar ne nevojshmeri per te kryer procesin e betonimit te panderprere per nje cilesi minimalisht te pranueshme sipas kushteve teknike te zbatimit.

6) Autopompe betoni, ky mjet sherben per hedhjen e betonit nga autobetonierja ne elementin strukturor ose jo te pergatitur per betonim
7) Rimorkiator, ky mjet sherben per transportimin e te gjithe makinerive me zinxhir/goma te nevojshem per punen ne sheshin e ndertimit (Pirun ngrites, Minifadroma, Minieskavator etj), si dhe per heqjen e tyre nga sheshi i ndertimit per te mos penguar proceset e rradhes te punes.
8) Matrapik per thyerje betoni, ky mjet eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve te prishjes se ndertesave,elementeve b/a ekzistuese.
9) Autobot uji, eshte i nevojshem per furnizimin me uje te kantierit gjate punimeve te ndertimit, mekanike, hidraulike, shkarkimet etj.
10) Betoniere / vellimi 1 m3, eshte e nevojshme per prodhimin e betoneve ne sasi te vogel te nevojshme perkohesisht per realizimin e zerave te ndryshme te punimeve, per prodhimin e betoneve per brezat b/a te cilat kane nevoje per sasi relativisht te vogel betoni ne raport me kohen.
11) Autovinc, i nevojshme per ngritjen me efikasitet te materialeve, veglave etj ne lartesi dhe levizjen e materialeve te renda ne plan per te rritur rendimentin e punes.
12) Minieskavator, i nevojshme per realizimin e germimeve te plintave dhe themeleve me gjeresi te vogel dhe gjithe punimet e germimit te nevojshme ne zona e ngushta aksesi ne sheshin e ndertimit.
13) Minifadroma, i nevojshme per realizimin e levizjes se materialve te te germimit ne zona te ngushta aksesi ne sheshin e ndertimit dhe per ngarkimin e tyre ne mjetet e transportit.
14) Krik ngrites , i nevojshme per ngritjen/mbajtjen e materialeve, mjeteve, elementeve te ndryshem para dhe gjate punimeve te ndertimit.
15) Kantier stacionar ,
16) Gjeneratore, te nevojshem per furnizmin me energji elektrike gjate momenteve te mungeses se energjise nga rrjeti si dhe gjate nevojes per furnizim me energji elektike te veglave te punes ne pamundesi te lidhjes me rrjetin energjitik ekzistues.
17) Tranxhe hekuri, e nevojshme per realizimin e punimeve te hekurit.
18) Skele suvatimi, jane te nevojshme per realizimin e punimeve te suvatimit dhe veshjeve brenda dhe jashte nderteses.
19) Nivelues per shtresa betoni, te nevojshme per realizimin e shtresave niveluese ne objekt dhe ne sistemimet e jashtme.
20) Pirun ngrites, i nevojshem per ngritjen dhe transportimin e mjeteve te caktuara ne lartesi deri ne 2.2 metra, per ngritjen e baletave me materiale dhe materiale te tjera te zakonshme.
21) Kompresor,
22) Vinxh Kulle 40m, është i nevojshëm pasi kemi punime rikonstruksioni dhe ndërtimi në objekte që shkojne ne lartesi. Meqënëse vinçi duhet të transportojë materiale në lartësi max ai duhet të jetë min mbi pikën më të lartë godines.
23)

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”(*i ndryshuar*) me VKM-në nr.

563, datë 03.07.2013 ”Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 ”Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 90 (nentedhjete) cope;
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 (gjashtë) cope;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 8 (tete) cope;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) cope
- Fikese zjarri 7 (shtate ) cope
- Tabela Sinjalizimi 20 (njezet ) cope

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne

pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

i) Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me makinerite/pajisjet që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

j)

| Nr | Lloji i mjetit | Specifikime teknike si tonazhi, kapaciteti mbajtes etj. | Pronesi/Qira | Data e nënshkrimit të kontrates së qirasë/blerjes |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

**.3.16 Operatori ekonomik duhet te disponoje**

**Fabrika prodhimi i inerteve Pronesi, ose Kontrate Qiraje, ose Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me QKL Kodi III.1.B.**

- Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në procedure të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë

**Bojra hidroplastike**;

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre per produktin Bojë për lyerjen e godinave, ambienteve të brendshme dhe të jashtme, shoqëruar me EN ISO 9001:2015, EN ISO 14001:2015, ISO 45001:2015 dhe PASS 99:2012, raport analizimi për bojë lyerje muri, lëshuar nga inspektoriati shtetëror teknik dhe industrial ose institucione të tjera të akredituara. Ne rastin e kontrates me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

- **Hekur;**
- **Pajisje elektrike**
- **Pajisje hidraulike**
- **Paisje kondicionimi**
- **Dyer & dritare**
- **Materiale hidroizoluese**

- Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, hekur, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 – 1:2016 .

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjerë që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.
- PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr.692 date 13.12.2001 *"Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr.742 date 06.11.2003"*, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rrugë kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

***Argumentimi***: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre "(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhiniere, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre" si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",*

***duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance**, **apo/dhe çdo standard të kërkuar,*** *ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

***Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST**.*